

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“BXH” sh.p.k

Tiranë, më datë 11/02/2025

NENI 1

Shoqëria Tregtare “BXH” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

NENI 2 - EMRI I SHOQËRISË

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “BXH” sh.p.k.

NENI 3 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të mëposhtme: në fushën e ndërtimeve, lyerjeve, import-eksport i materialeve të ndërtimit, ndërtimin dhe operimin e sistemeve dhe programeve kompiuterike, konsulencë dhe mirëmbajtje të sistemeve kompjuterike


NENI 4 - SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla B, kati 5, Tiranë.

NENI 5 - KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100.000 Lek. Kapitali ndahet në katër (4) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. Xhoana Ismalaj, lindur në Laç, më 23/10/1996, shtetase Shqiptare, mbajtëse e pasaportës me nr.BF8518624, me nr ID J66023038U zotëron 55% të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (55.000) lekë.

 1
AKT THEMELIMI “BXH” shpk

2. Arbër Bara, lindur në Burrel, më 20/04/1988, shtetas Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit, me nr 037715123, dhe ID 180420094Q zotëron 35% të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (35.000) lekë.
3. Ilir Qafa, lindur në Berat, 09/06/1978, shtetas Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit, me nr 033276346, dhe ID H80609066H zotëron 5% të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (5000) lekë.
4. Armir Jangulli, lindur në Godvi, 12/09/1996, shtetas Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit, me nr 038961234, dhe ID J60912011C zotëron 5% të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (5000) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

NENI 6 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7 - ORGANET DREJTUESE

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat dy vjeçar me të drejtë rrizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është Xhoana Ismalaj, lindur në Laç, më 23/10/1996, shtetase Shqiptare, mbajtëse e pasaportës me nr.BF8518624, me nr ID J66023038U, persone madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 2 (dy) vitesh. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11




Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Akt i Themelimit hartohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU

Xhoana Ismalaj

Xhoana Ismalaj

(emer, mbiemer, firme)



ORTAKU

Arbër Bara

Arbër Bara


(emer, mbiemer, firme)

ORTAKU

Ilir Qafa

Ilir Qafa

(emer, mbiemer, firme)



ORTAKU

Armir Jangulli

Armir Jangulli

(emer, mbiemer, firme)

